

## **Titulli i projektit: Marrëveshje Bashkëpunimi 2 ndërmjet, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT dhe Agjencisë e Suedeze të Taksave (STA)**

**Afati kohor i projektit: Prill 2026-2030**

*( në proces miratimi)*

Projekti i ri katërvjeçar i bashkëpunimit institucional midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) në Shqipëri dhe Agjencisë Tatimore Suedeze (STA), i financuar nga Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida), pritet të fillojë në muajn Prill 2026 me një kohëzgjatje 4 vjeçare deri në Mars 2030.

Projekti synon të forcojë kapacitetet e DPT-së për të përmbushur kërkesat për anëtarësim në BE sipas Kapitullit 16 “ Taksimi”. Projekti mbështetet në rezultatet e bashkëpunimit 2022-2026 dhe i përgjigjet drejtpërdrejt nevojave të Shqipërisë për përafrim me BE-në, Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave dhe Planit Strategjik të DPT-së 2024-2028.

Qëllimi është të mbështetet zhvillimi i një administrate tatimore moderne, të parashikueshme dhe të mirëqeverisur, të aftë për të zbatuar legjislacionin tatimor të harmonizuar me BE-në, duke ofruar shërbime të qëndrueshme për taksapaguesit dhe duke menaxhuar të dhënat sipas standardeve të njohura.

Shqipëria po avancohet në procesin e anëtarësimit në BE dhe modernizimin e sektorit publik. Për administratën tatimore, kjo nënkupton qartë nevojën për përafrim të vazhdueshëm tatimor me acquis-në e BE-së. Për këtë, ky bashkëpunim ndërmjet DPT-së dhe STA-së do të mbështesë gjithashtu zhvillimin e biznesit dhe ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, si dhe fushat e identifikuar në MTRS dhe në Planin Strategjik të DPT-së 2024–2028, me qëllim krijimin e një administrate tatimore edhe më moderne dhe më efektive.

Projekti do të ketë këto tre objektiva kryesore:

- Përafrimi për Anëtarësimin në BE dhe gatishmëria për shkëmbim të të dhënave
- Përmirësimi i Qeverisjes së Mirë dhe i Shërbimeve ndaj tatimpaguesve
- Forcimi i Zhvillimit të Biznesit dhe i Kapaciteteve me rutina praktike të administrimit të të dhënave sipas standardit ISO 27001.

Çdo komponent synon prodhimin e rezultateve konkrete, si analiza të boshllëqeve, drafte legjislative, URD/ToR, manuale procesesh, katalogë shërbimesh, përmbledhje të KPI-ve, rregulla të cilësisë së të dhënave, rishikime të procedurave të reagimit ndaj incidenteve dhe ushtrime për vazhdimësinë e veprimtarisë.

Deri në vitin 2030, projekti pritet të ketë kontribuar në një administratë tatimore të mirëqeverisur, të besueshme dhe në përputhje me BE-në, me kapacitete institucionale të forcuara, ofrim të qëndrueshëm shërbimesh dhe praktika të forta të qeverisjes së të dhënave – duke mbështetur progresin e Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE dhe përmirësimin e performancës së sektorit publik.